



Republika e Kosovës

Komuna e Malishevës



Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

Nr: 11/

Më:

PRILJENJE:

ACCEPTED ON:

PRILJENJE:

Nr.No.Bi:

12/08/2022

11/1419

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 06/L-114, Kapitullit V nenit 67 dhe 68, e në bazë Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr:151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo- Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës , Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit , Përfundimit të Kontratave dhe Emërimit të Përkohshme, e në mbështetje të pikës 16 të Nenit 11 të Kontratës Kolektive datë, 22.01.2021. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lirë të punës drejtor në këto shkolla:

Nr	Niveli, Shkolla	Vendi	Titulli mbikëqyrësit	Lloji pozitiv	Titulli punës	Koeficienti:	Orë: në javë	Kohëzgjatja e emërimit
1	SHFMU" Afrim Buçaj"	Lladroc	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
2	SHFMU" Beqir Gashi"	Mleqan	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
3	SHFMU" Dëshmorët e Kombit"	Ngucat	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
4	SHFMU" Gjergj Fishta"	Senik	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
5	SHFMU" Gjergj Kastrioti"	Llëviz	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
6	SHFMU" Imer Krasniqi"	Carrallukë	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
7	SHFMU" Migjeni"	Lumishtë	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
8	SHFMU" Petro Nini Luarasi"	Llapqevë	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
9	SHFMU" Rifat Berisha"	Berishë	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
10	SHFMU" Vesel Pagarusha"	Pagarushë	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
11	SHFMU" Visar Krasniqi"	Drenoc	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
12	SHFMU" Xhevë-Krasniqi-Lladroci"	Drenoc	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
13	SHFMU" 17 Shkurti"	Begaj	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
14	SHFMU" 18 Prilli"	Burim	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
15	SHFMU" 28 Nëntori"	Kërvasari	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
16	IP" Çerdhja" Zërat e Ëmbël"	Malishevë	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite
17	SHFMU" Habib Berisha"	Grbardh	Drejtori i Arsimit	Jo karrierës	Drejtor	7.8	40	4 (katër) vite

Qëllimi i vendit të punës:

Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit arsimor në institucionin edukativo-arsimor.

Detyrat Kryesore:

- Zbatimi i ligjshmërisë në fushën e arsimit;
- Zhvillimin e një plani afatgjatë për aktivitetin e drejtorisë;
- Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore,
- Aftësimin e personelit në Institucion,
- Planifikimin dhe shfrytëzimin racional të buxhetit,
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit,
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit të informimit për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlikuara të praktikës,
- Caktimin e masave disiplinore ndaj nxënësve,
- Planifikimin, udhëheqjen dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve në institucion,
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes këtij ligji dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

Kushtet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelet e kualifikimit që i plotsojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm dhe normativit për arsim profesional në fuqi;
- Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsimit (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Master arsimor (kualifikimi prej 300 ECTS, së paku 5 vite shkollim universitar);
- Katërvjeçar (kualifikim prej 240 ECTS, së paku 4 vite të shkollimit universitar);
- Bachelor katërvjeçar (kualifikimi prej 240 ECTS, së paku 4 vite të shkollimit universitar);
- Të ketë licencës të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve;
- Të ketë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsimit, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASH sipa rekomandimeve të KSHLM;
- Të ketë përvojë pune në procesin edukative – arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës;
- Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për arsimin e mesëm të lartë;
- Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor/eshës në nivele tjera;

Dokumentet e nevojshme që kërkohen:

- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë;
- Kandidati/ja që ka të përfunduar programin univerzitar Master për udhëheqje, administrimin ose menaxhim në arsim, në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim, ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeve;
- Të ketë licencës të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilin dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshminë se nuk është nën hetime, dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët (origjinal);
- Dëshmi mbi përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor;
- Dekleratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike;
- Portofolin profesional, me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/ formularin H të këtij UA;
- Kandidati/ja në një konkurs publik, ka të drejtë të aplikojë në një e më shumë shkolla. Në raste të tilla përgatit dokumentacionin të ndarë për secilën shkollë ku aplikoni;
- Çertifikata e lindjes, (kopje);
- Letër referencë nga një institucion publik kredibile (si Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, DKA, Këshilli Drejtues i Shkollës, punëdhënësi paraprak, Institucionet e Arsimit të lartë);
- Letrat e referencës duhet të ketë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake;
- Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues për të cilin ka konkurruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12: Arial) sipas udhëzimeve të MASHT-it,

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim me Qytetar në Komunën e Malishevës. Data e njoftimit në web faqen; <https://kk.rks-gov.net/malisheve/category/shpalljet/>, është prej dt; 12.08.2022 deri me dt, 11.09.2022, ndërsa data e aplikimit është nga dt; 12.09.2022 deri me dt; 26.09.2022. Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohen nga Komision, ndërsa në intervistë do të ftohën vetëm kandidatët nga lista e ngushtë.

Të gjithë kandidatët që kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kushte të konkursit.

Rezultatet shpallën në linkun: <https://kk.rks-gov.net/malisheve/category/shpalljet/konkurset/>

Malishevë: 12.08.2022

